



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

*Praktë*

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Nr. 70 Prot.(Xh.S)

Vlorë, më 22 /01/2018

**Lënda:** Dërgohet urdhëri i ekzekutimit të vendimit penal.

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË

V L O R Ë

ZYRËS PËRMBARIMORE

V L O R Ë

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

V L O R Ë

DHOMËS SË AVOKATISË

Av. Arjan Zyka

V L O R Ë

Shtetasit: Enkelejda Isakaj

Lagjia "28 Nëntori"

V L O R Ë

I nderuar zotëri,

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë urdhërin e prokurorit nr.70, datë 20/01/2018, për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë nr.591, datë 05/11/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe aktet bashkëngjitur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Ardian YLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

URDHËR

Nr.70, datë 20/01/2018

Për ekzekutimin e vendimit nr.591, datë 05/11/2015  
të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Në Vlorë, viti 2018, muaji Janar, datë 20.

Unë Xhemal Saliqaj, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pasi u njoha me përmbajtjen e vendimit penal nr.591, datë 05/11/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërguar me kërkesën nr.793, datë 19/01/2018, për të dënuarën: Enkelejda Isakaj, e bija e Mefjetit dhe e Fetes, e datëlindjes 14/06/1974, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, Lagjia "28 Nëntori", e hetuar dhe gjykuar pa masë të sigurimi personal, (në mungesë), mbrojtur nga av.Arjan Zyka,

KONSTATOVA:

Se me vendimin penal nr.591, datë 05/11/2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurës Enkelejda Isakaj për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave". parashikuar nga Neni 186, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 (dy) vjet burgim.
2. Në zbatim të Nenit 406, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimin për të pandehurën Enkelejda Isakaj, duke e dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
3. Në zbatim të Nenit 391/1 i Kodit të Procedurës Penale, dokumentet e sekestruara:
  - a) Prokurë e posaçme nr.1211 Rep, nr.477 Kol, datë 12/05/2011, në emër të Raime Latifi,
  - b) Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr.679 Rep, nr.406 Kol, datë 19/04/2012, lidhur midis shtetas Raime Latifi, e përfaqësuar nga e pandehura Enkelejda Isakaj dhe shtetasve Edison Alili dhe Elda Bombaj,

- c) *Çertifikatë e pronësisë e pasurisë së palujtshme nr.28/476/1, ZK 8603, vol.32, faqe 206, lëshuar në datën 15/03/2012, bashkë me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese, të deklarohen të fallsifikuara, duke u urdhëruar asgjesimi i tyre.*
4. Në zbatim të Nenit 36/b të Kodit Penal dhe Nenit 190/1/a, të Kodit të Procedurës Penale prova materiale, produkt i veprës penale të "Fallsifikimit të dokumentave". më shumë se një herë, parashikuar nga Neni 186, paragrafi i dytë i Kodit Penal, e ndodhur nën efektin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive:
- *Pasuria e palujtshme e llojit truall, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> (një mijë metër katëror) me nr.28/476/1, vol.32, faqe 206, ZK 8603, Vlorë, të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.*
5. Shpenzimet procedurale të kryera në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e gjyqimit, në shumën totale 4 000 (katër mijë) lekë, janë në ngarkim të të pandehurës.


*Vendimi penal nr.591, datë 05/11/2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë formë të prerë me vendimin nr.743, datë 23/11/2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur:*

1. Lënin në fuqi të vendimit nr.591, datë 05/11/2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Për sa më sipër, bazuar në Nenin 462, Nenin 464, Nenin 465 dhe Nenin 486, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, si dhe Nenin 12, Nenin 17, Nenin 22 dhe Nenin 23 të Ligjit nr.8331, datë 21/04/1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale",

### URDHËROJ:

1. Ekzekutimin e vendimit penal nr.591, datë 05/11/2015 nr.182, datë 06/04/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim vuajtjen e dënimit me burgim, disponimin mbi provat materiale, si dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore.
2. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me kapjen dhe transportimin e të dënuarës Enkelejda Isakaj në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, për vuajtjen e dënimit me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim, urdhërohet policia gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.
3. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me asgjesimin e provës materiale të sekuestruar. Konkretisht:
- a) *Prokurë e posaçme nr.1211.Rep, nr.477.Kol, datë 12/05/2011, në emër të Raime Latifi,*
- b) *Kontratë shitje e pasurisë së palujtshme nr.679 Rep, nr.406 Kol, datë 19/04/2012, lidhur midis shtetas Raime Latifi, e përfaqësuar nga e pandehura Enkelejda Isakaj dhe shtetasve Edison Alili dhe Elda Bombaj,*
- c) *Çertifikatë e pronësisë e pasurisë së palujtshme nr.28/476/1, ZK 8603, vol.32, faqe 206, lëshuar në datën 15/03/2012, bashkë me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese, urdhërohet policia gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.*




2

4. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të provës materiale, produkt i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave". më shumë se një herë, parashikuar nga Neni 186, paragrafi i dytë i Kodit Penal, e ndodhur nën efektin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, Konkretisht:

*✓ Pasuria e palujtshme e llojit truall, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> (një mijë metër katëror) me nr.28/476/1, ZK 8603, vol.32, faqe 206, Vlorë, ngarkohet Zyra Përmbaremore Vlorë.*

5. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me pagimin e shpenzimeve gjyqësore në shumën 4 000 (katër mijë) lekë nga e dënuara Enkelejda Isakaj, ngarkohet Zyra Përmbaremore Vlorë.
6. Me këtë urdhër të njoftohet i dënuari, mbrojtësi i tij, si dhe Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë.
7. Për zbatimin e këtij urdhëri të njoftohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

  
**PROKURORI**  
**Xhemal SALIAJ**